

VENDIM
Nr. 712, datë 26.8.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I RRUGËS HYRËSE
TË DOGANËS MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 5, pikat 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës hyrëse të Doganës Morinë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "arë", "truall" dhe "pemëtore" (tokë bujqësore), me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 285 436 (dyqind e tetë dhjetë e pesëmijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë "arë", me sipërfaqe 208 (dyqind e tetë) m², me vlerë shpronësimi 23 712 (njëzet e tre mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) lekë;

b) tokë "truall", me sipërfaqe 1 246 (një mijë e dyqind e dyzet e gjashtë) m², me vlerë shpronësimi 251 692 (dyqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë;

c) pemëtore (tokë bujqësore), me sipërfaqe 88 (tetëdhjetë e tetë) m², me vlerë shpronësimi 10 032 (dhjetë mijë e tridhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 285 436 (dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, zëri "Investime".

5. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 3, 4, 5 dhe 7, të këtij vendimi.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e sipërfaqes së shpronësuar mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit.

8. Afati i përfundimit të punimeve për ndërtimin dhe realizimin e shpronësimit do të jetë sipas përcaktimeve të kontratës për realizimin e zgjerimit të rrugës hyrëse të Doganës Morinë.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së sipërfaqes së shpronësuar mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E PRONARËVE PRIVATË QË DO SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË
ZGJERIMIT TË RRUGËS HYRËSE NË DOGANËN MORINË, KUKËS**

Fshati	Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. m²	Çmimi, lekë/m²	Vlera totale, lekë	Lloji i vërtetimit
									Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Morinë	1	Rive Iljaz Duraku	2724	91/15	Arë	208	114	23,712	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	2	Xhevahire Qazim Gjuta (Duraku) (B/50%), Hazir Qazim Duraku (B/50%)	2724	92/3 (92/3/1)	Truall	459	202	92,718	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	3	Seladin Ymer Duraku, Lavdi Ymer Duraku, Sanije Ymer Gjuta, Elmije Ymer Ahmetaj, Shkurte Imer Dogjani, Zelihe Ymer Kadena, Myrvete Ymer Sinani, Ilir Hysni Duraku, Shkumbin Hysni Duraku, Arjana Hysni Peposhi, Laureta Hysni Asllanaj (Duraku), Fidaije Hysni Brahimi (Duraku), Gazmir Hysni Duraku	2724	92/4 (92/4/1)	Truall	787	202	158,974	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	4	Lavdi Imer Duraku	2724	238/12	Pemëtore (tokë bujqësore)	88	114	10,032	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		Shuma				1,542	167	285,436	